

AKT NORMATIV
Nr. 24, datë 27.5.2020

**PËR NJË SHITESË NË AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT
TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas pikës 21, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 22, me këtë përmbajtje:

“22. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari turistike në stacionet e plazhit dhe që nuk respektojnë rregullat dhe protokollet e sigurisë, të nxjerra nga organet kompetente, dënohen me gjobë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë nga inspektoratet përgjegjëse.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 109, datë 09.06.2020